



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja

Adresa: Rruga "Abdi Toptani" Nr. 1 Tiranë.

E-mail: klsh.org.al; web-site www.klsh.org.al

Nr. 797/4 Prot.

Tiranë, më 17.12.2018

V E N D I M

Nr. 199 , Datë 17.12.2018

PËR

AUDITIMIN E USHTRUAR NË KORPORATËN ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE, PROJEKTI “SIGURIA E DIGAVE”, “AUDITIM PËRPUTHSHMËRIE DHE RREGULLSHMËRIE”, për periudhën nga data 01.01.2015 deri më datën 30.06.2018

Nga auditimi i ushtruar në Korporatën Elektroenergjetike Shqiptare KESH SHA, Projekti “Siguria e Digave” rezultuan devijime/shkelje nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi në disa nga pikat e programit të auditimit.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, me qëllim përmirësimin e gjendjes.

VENDOSA:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit të ushtruar në Korporatën Elektroenergjetike Shqiptare, Projekti “*Siguria e Digave*” me objekt “Auditim Përputhshmërie dhe Rregullshmërie”, sipas programit nr. 797/1 prot., datë 13.07.2018 për periudhën nga data 01.01.2015 deri më datën 30.06.2018.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: KLSH nga auditimi i mëparshëm ka rekomanduar 26 masa gjithsej, nga këto: 16 masa organizative, 4 shpërblim dëmi dhe 6 masa disiplinore. Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a. *Masa organizative:* Janë rekomanduar 16, nga të cilat janë pranuar 15 masa, nga të cilat janë zbatuar plotësisht 14 dhe 1 masë është në proces.

b. *Masa për shpërblim dëmi:* Janë rekomanduar 4 masa, nga të cilat janë pranuar 2 dhe nga këto është realizuar plotësisht 1 dhe 1 masë është realizuar pjesërisht.

c. *Masa me karakter disiplinor:* Janë rekomanduar 6 masa disiplinore, nga të cilat janë pranuar dhe zbatuar plotësisht (*Më hollësisht trajtuar në pikën 1 në faqet 7-13, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandimi: Nga KESH SHA të merren masa për realizimin e plotë të rekomandimeve të dhëna në auditimin e mëparshme të KLSH të cilat kanë rezultuar të parealizuara ose në proces.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të dosjes së shërbimit të konsulencës për kontratën me objekt *“Asistencë teknike në implementimin e projektit”* rezultoi se kjo kontratë është lidhur mes *Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (KESH)* dhe *“A... C...” Ltd* në rolin e konsulentit të projektit me datë 16.12.2009, me vlerë fillestare të kontratës 2,289,579.4 €. Më pas vlera e kontratës është rritur me amendamentet përkatëse deri në vlerën 4,770,957.22 €. Nga auditimi i pagesave pjesore për periudhën objekt auditimit u konstatua se i janë likuiduar konsulentit të projektit shërbime të pakryera në fakt dhe/apo të pajustificuara me dokumentet përkatëse në vlerën **2,090,664 lekë**, veprime këto në kundërshtim me kontratën e shërbimit të konsulencës të lidhur me datë 16.12.2009 me nr. DSP 01–09 e ndryshuar sipas amendamentit nr. 7 të marrëveshjes së datës 31.05.2018. Konkretisht, me Kushtet e Përgjithshme, pika 3 Detyrimet e Konsulentit, pikat 3.1.1-Standardi i Performancës, 3.1.2-Ligjet rregulluese të shërbimeve, pika 6-Pagesat ndaj Konsulentit, nënpika 6.4-Mënyra e Faturimit, paragrafi b, c (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6.2 në faqet nr. 38 – 47 të Raportit Përfundimtar të auditimit*).

2.1 Rekomandim: Nga KESH SHA dhe PMU të merren masa për t'i kërkuar konsulentit të projektit *“A... C.... Ltd”*, plotësimin e dokumenteve përkatëse që justifikojnë kryerjen e pagesave në përputhje me kushtet e kontratës.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratave me objekt *“Supervizim permanent punimeve për rehabilitimin e bjeftit të poshtëm të digës së HEC – Koman”* (dy kontrata për këtë shërbim) të lidhura sipas akteve nr. 7302/7 prot., datë 24.10.2014 me vlerë 1,440,000 lekë me TVSh dhe nr. 8037/2 prot., datë 03.02.2015 me vlerë 6,270,000 lekë me TVSh mes KESH SHA dhe *“C.... R...”*, si dhe nga auditimi i kontratës së shërbimit të konsulencës me objekt *“Asistencë teknike në implementimin e projektit”* të lidhur me datë 16.12.2009 me nr. DSP 01-09 midis KESH SHA dhe *“A... C...” Ltd* në rolin e konsulentit rezultoi se këto tri kontrata shërbimi lidhen me zbatimin e kontratës për punime civile në objektin *“Konsolidimi i bjeftit të poshtëm të Komanit dhe largimi i depozitimeve në kanalin e shkarkimit”*. Kontratat e mbikëqyrjes me *“C... R...”* janë lidhur pasi nga

ana e konsulentit nuk ka qenë parashikuar në skedulën e ofertës supervizimi i përditshëm për punimet e kontratës së zbatimit me objekt si më sipër. Në fakt ky skedul oferte është plotësuar me ditë pune sipas skedulit që ka parashikuar vetë KESH SHA në vitin 2009 (pra jo me supervizim të përditshëm) dhe mungesa e një ofertimi të tillë ishte një fakt i pritshëm në momentin e zbatimit të kontratës së shërbimit dhe asaj të zbatimit të punimeve. Për rrjedhojë, lidhja e kontratave shtesë ka çuar jo vetëm në konfuzion dhe mbivendosje kompetencash por edhe në kryerjen e pagesave të dyfishta në drejtim të subjekteve të ndryshme për shërbime specifike (detyrave funksionale) duke rritur kështu vlerën dhe koston totale të projektit e si rrjedhojë duke rënduar edhe buxhetin e shoqërisë KESH SHA. Vlera e shërbimeve të njëjta të paguara dy herë për subjekte të ndryshme nuk është përcaktuar qartë pasi shërbimet nuk janë mbivendosur në masën 100 % të tyre, por janë mbivendosur detyra specifike të marra përsipër nga “A... C...” Ltd dhe njëkohësisht nga “C... R...” (Më hollësisht trajtuar në pikën 6.4 në faqet 49-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandim: Në vazhdimësi, KESH SHA dhe PMU të nxirren përgjegjësitë për situatën e krijuar në lidhje me këtë mbivendosje të detyrave specifike mes mbikëqyrësit dhe konsulentit si dhe të bashkëpunohet mes tyre në të ardhmen në mënyrë të efektshme nëpërmjet përcaktimit të saktë të nevojave për shërbime konsulence dhe nevojave për mbikëqyrje punimesh (metodikën, natyrën, llojin, etj.) në përputhje me nevojat konkrete që parashikojnë projektet me financime të huaja duke shmangur mbivendosjen e të njëjtave detyrave funksionale të atribuara operatorëve të ndryshëm.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se afati i disbursimit jo vetëm që nuk është përmbushur por ka pasur disa shtyrje në afat me më shumë se 2 vite nga data 31.12.2016 i përcaktuar në marrëveshjen e kredisë. Gjithashtu, afati i disbursimeve deri në fund të muajit dhjetor 2018 nuk do të mund të përmbushet për arsye se kontrata e lidhur për remontin e agregateve të HEC Koman nuk ka përfunduar për shkak të vonesave gjatë zbatimit, si dhe shtesa e fondit e akorduar në qershor të vitit 2018 e cila e ka shtyrë afatin e realizimit deri në fund të vitit 2020 pasi agregati i fundit është demontuar për remont në Maj të vitit 2018. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 në faqet 18-23, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandim: Njësia e Zbatimit të Projektit/KESH dhe KESH SHA të nxjerrë përgjegjësitë për mos realizimin në afat të disbursimeve, duke pas parasysh dhe afatin e përfundimit të punimeve në remontin e makinerive dhe punimeve mbrojtëse të digës, si dhe të marrin masa për përmbushjen e disbursimeve të huasë brenda afatit të miratuar 31.12.2020 për arritjen e objektivave dhe rritjen e performancës së HEC Koman.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi : Nga auditimi u konstatua se nga fillimi i projektit deri në periudhën e auditimit, janë disbursuar në total 48,142,425 € ose 60 % të huave gjithsej, nga të cilat shuma 25,351,582 € nga Kredia e IDA ose 96 % e kredisë; shuma prej 6,284,552 € nga huaja e IBRD ose 49.5 e huasë; shuma 11,058,772 € nga Kredia e EBRD ose 71.3 % e kredisë; shuma prej 5,127,762 € nga kontributi i qeverisë Zvicerane (SECO) ose 96 % e kontributit; shuma prej 284,807 € nga kontributi grant i KfW ose 89 % e kontributit dhe shuma prej 372,700 € nga kredia e KfW ose 0.18 % e kredisë për vetë faktin se është miratuar në 2018. Edhe pse niveli i disbursimeve për kë hua duhet ishte në nivele më të larta apo plotësisht i realizuar në respektim të kontratave fillestare si dhe për të mënjeluar kostot shtesë në lidhje me tarifën e angazhimit prej 0.5% në vit, për

shumën e pa disbursuar të huasë (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4 në faqet 18-23, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1 Rekomandim: Nga Njësia e zbatimit të projekteve të merren masa që në vazhdimësi të respektohet afati i kontratave të zbatimit të punimeve dhe realizimi në kohë i disbursimeve nga huadhënësit për të eliminuar maksimalisht kostot shtesë të projektit dhe rënduar situatën financiare të shoqërisë, nisur dhe nga fakti i shtyrjeve të vazhdueshme të afateve dhe projektit.

Deri në 31.03.2019

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se projekti për implementimin e masave për Sigurinë e Digave është parashikuar të realizohet nëpërmjet një financimi të përbashkët të Bankës Botërore institucioneve të tjera financiare si SECO, EBRD, KfW, KESH etj. Në objektivat e tij janë realizuar masat mbrojtëse për shpatet e digave të cilat kanë përfunduar sa i përket HEC Fierzë dhe Koman, si dhe Sistemi i Kontroll Monitorimit është në proces zbatimi në HEC Koman. Janë realizuar sistemet përkatëse të monitorimit për HEC Fierzë. Janë realizuar sistemet e monitorimit gjeologjik dhe sizmik. Ka përfunduar rehabilitimi i 3 agregateve të HEC-Koman ndërkohë që i katërti është në proces, ka filluar demontimin në 7 Maj 2018. Ka përfunduar mbrojtja e bjeftit të poshtëm të skarpatës së digës për HEC Koman. Edhe pse gjatë periudhë objekt auditimi realizimi i objektivave ka ecur në ritme të kënaqshme përsëri nga ana e subjekteve nuk janë respektuar afatet ku në dy raste kontrata e datës 02.07.2012, ka patur dhe penalitete duke sjellë vonesa në vënien në eficiencë të plotë këtë investim (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3 në faqet nr. 16 – 18 të Raportit Përfundimtar të auditimit*).

6.1 Rekomandim: Njësia e zbatimit të projekteve të marrin masa në përmbushjen e objektivave të projektit si dhe arritjen e tyre në kohë dhe cilësi për vënien në eficiencë maksimale HEC-et e kaskadës së lumit Drin dhe rritjen e gatishmërisë dhe cilësisë së shërbimit të shoqërisë në tregun e energjisë elektrike.

Në vijimësi

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit teknik të dosjes së zbatimit për kontratën e punimeve me objekt “*Konsolidimi i bjeftit të poshtëm të Komanit dhe largimi i depozitimeve në kanalën e shkarkimit*” të lidhur sipas aktit me nr. DSP – EBRD 02-13 datë 10.02.2014 mes *Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (KESH)* të përfaqësuar nga administratori z. A. H. dhe “P... B... G...”, me vlerë 5,296,618 € pa TVSH u konstatua se i janë likuiduar tepër në vlerën **27,299,778 lekë¹** kontraktorit nga të cilat vlera 26,912,053 lekë si pasojë e përfshirjes në pagesat pjesore të punimeve të pakryera në fakt dhe vlera 387,725 lekë dhe prej mos aplikimit të penaliteteve për vonesa në përfundimin në afat të punimeve, në kundërshtim vlera e fundit me amendamentin e kontratës së sipërmarrjes së punimeve të datës 02.02.2016 Seksioni 5 dhe paragrafin 8.7 të kontratës bazë (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6.1 në faqet nr. 23-38 të Raportit Përfundimtar të auditimit*).

1.1 Rekomandim: Nga KESH SHA dhe PMU, të merren masa, për t’i kërkuar sipërmarrësit të punimeve “P... B... G...”, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjyqimit arkëtimin e shumës **27,299,778 lekë** të përfutur tepër si pasojë situacionimit

¹ Kursi i këmbimit për gjetjen nr. 1 dhe nr. 2 është marrë sipas datës së kursit zyrtar të datës së pagesës IPC (situacionit pjesor) të paraqitur nga ana e sipërmarrësit apo konsulentit, sipas rastit.

dhe likuidimit të punimeve të pakryera në fakt, vlera 26,912,053 lekë dhe prej mos aplikimit të penalteteve për vonesa në përfundimin në afat të punimeve, vlera 387,725 lekë, në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. DSP – EBRD 02-13, e amenduar me objekt “Konsolidimi i bjefit të poshtëm të Komanit dhe largimi i depozitimeve në kanalin e shkarkimit”.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të dosjes së shërbimit të konsulencës për kontratën me objekt “Asistencë teknike në implementimin e projektit” rezultoi se kjo kontratë është lidhur mes *Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (KESH)* të përfaqësuar nga ish – administratori dhe “A... C...” Ltd në rolin e konsulentit të projektit me vlerë fillestare të kontratës 2,289,579.4 €. Më pas vlera e kontratës është rritur me amendamentet përkatëse deri në vlerën 4,770,957.22 €. Nga auditimi i pagesave pjesore për periudhën objekt auditimit u konstatua se i janë likuiduar tepër në vlerën **2,090,664 lekë** konsulentit të projektit si pasojë e përfshirjes në këto pagesa të shërbimeve të pakryera në fakt dhe/apo të pajustificuara me dokumentet përkatëse, veprime këto në kundërshtim me kontratën e shërbimit të konsulencës të lidhur me datë 16.12.2009 me nr. DSP 01–09 e ndryshuar sipas amendamentit nr. 7 të marrëveshjes së datës 31.05.2018. Konkretisht, me Kushtet e Përgjithshme, pika 3 Detyrimet e Konsulentit, pikat 3.1.1 Standardi i Performancës, 3.1.2 Ligjet rregulluese të Shërbimeve, pika 6 Pagesat ndaj Konsulentit, nënpika 6.4 Mënyra e Faturimit, paragrafi b, c (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6.2 në faqet nr. 38-49 të Raportit Përfundimtar të auditimit*).

2.1 Rekomandim: Nga KESH SHA, të merren masa për t’i kërkuar konsulentit të projektit “A... C...” Ltd, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e shumës **2,090,664 lekë** të përfituar tepër si pasojë përfshirjes në pagesat pjesore të shërbimeve të pakryera në fakt dhe/apo të pajustificuara me dokumentet përkatëse në kundërshtim me kushtet e kontratës së shërbimit të konsulencës të lidhur me datë 16.12.2009 me nr. DSP 01 – 09.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratës së projektit Siguria e Digave lidhur në korrik të 2012 midis KESH SHA dhe “A... H... G...” Austri për “Rehabilitimin Elektromekanik dhe instalimin e kontrolleve të reja dhe monitorimin me sistemin (CMS) të HEC Koman” me një vlerë fillestare kontrate prej 25,626,702 euro, dhe vlerë të amenduar 28,807,957 euro, rezulton se në remontin e agregateve 1 dhe 3, përpos amendimeve të afateve, nuk është respektuar afati i realizimit të punimeve. KESH SHA, edhe pse ka lëshuar faturë komerciale për kontraktorin për shlyerjen e penalteteve në vonesa, nuk ka llogaritur saktë këto penaltete. Shuma e llogaritur më pak është në total **24,254,028 lekë**, (*10,788,620 lekë për vitin 2015 dhe 13,465,408 lekë për vitin 2017*), të cilat përbëjnë dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë që i duhet mbajtur subjektit “A... H... G...” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 7 në faqet nr. 55-58 të Raportit Përfundimtar të auditimit*).

3.1 Rekomandim: Nga KESH SHA dhe Administratori të marrin masa për të analizuar shkaqet e vonesave nga kontraktori, si dhe pasojat që ka sjell vonesa e vendosjes në punë të agregateve në të ardhura e mungesa në prodhimin e energjisë dhe pas analizës në bazë të raportit të ardhura të munguara/penaltete, të vendosi për arkëtimin ose jo nga kontraktori i punimeve “A... H... G...”, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për shumën **24,254,028 lekë**.

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratave me objekt “*Supervizim permanent punimeve për rehabilitimin e bjeftit të poshtëm të digës së digës së HEC – Koman*” (dy kontrata për këtë shërbim) të lidhura sipas akteve me nr. 7302/7 prot., datë 24.10.2014 me vlerë **1,440,000 lekë me TVSh** dhe me nr. 8037/2 prot., datë 03.02.2015 me vlerë **6,270,000 lekë me TVSh** mes KESH SHA e përfaqësuar nga Administratori dhe “C... R...” e përfaqësuar nga ing. R. Gj., si dhe nga auditimi i kontratës së shërbimit të konsulencës me objekt “*Asistencë teknike në implementimin e projektit*” të lidhur me datë 16.12.2009 me nr. DSP 01-09 mes KESH SHA në rolin e klientit e përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm dhe “A... C...” Ltd në rolin e konsulentit rezultoi se të dyja këto kontrata shërbimi lidhen me zbatimin e punimeve civile në objektin “*Konsolidimi i bjeftit të poshtëm të Komanit dhe largimi i depozitimeve në kanalën e shkarkimit*”. Kontrata e lidhur me konsulentin “A... C...” Ltd, sipas amendamentin nr. 4 të datës 26.02.2016 ka parashikuar ndryshime në *Qëllimin e Shërbimeve*, ndryshime në afatin e shërbimit të konsulencës deri në 31.05.2017 si dhe rritjen e vlerës së shërbimit të konsulencës me 588,466.20 €. Nga kjo, vlera 7,027,430 lekë (50,779.90 €) rezulton se përfshin në brendësi të saj shërbime të cilat janë të parashikuara për tu kryer nga ing. G. L. i cili referuar akt-marrëveshjes të datës 28.11.2014 ka marrë përsipër dhe është pranuar nga ana e KESH SHA për supervizionin për ndërtimin e pilotave dhe strukturave të tjera prej betoni në këtë objekt. Referuar këtyre fakteve vlera e mësipërme prej **7,027,430 lekë** e parashikuar për t’iu likuiduar “A... C...” Ltd për shërbime konsulence ka në brendësi të saj vlera të mbivendosura të cilat deri tani janë efekt financiar negativ (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6.4 në faqet nr. 49-55 të Raportit Përfundimtar të auditimit*).

1.1 Rekomandim: KESH SHA dhe PMU të marrin masa për të analizuar vlerën prej **7,027,430 lekë** të vënë në dispozicion në konsulentin “A... C...” Ltd lidhur me shërbimet e mbivendosura mes tij dhe mbikëqyrësit të punimeve “C... R...” për evidentimin e vlerës së plotë të shërbimeve të mbivendosura, nxjerrjen e përgjegjësisë për veprimet dhe mosveprimet e kryera në lidhje me këtë praktikë si dhe arkëtimin e shumës të konstatuar me pasojë dëm për projektin. Gjithashtu, në vazhdimësi të bashkëpunojnë në mënyrë të efektshme nëpërmjet ndarjeve të qarta të detyrave mes palëve me qëllim shmangien e efekteve financiare negative si pasojë e mbivendosjeve të shërbimeve të njëjta në kontrata të ndryshme konsulence dhe/apo mbikëqyrjeje.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës së projektit Siguria e Digave lidhur në korrik të 2012 midis KESH SHA dhe “A... H... G...” për “*Rehabilitimin Elektromekanik dhe instalimin e kontrolleve të reja dhe monitorimin me sistemin (CMS) të HEC Koman*” rezulton se vonesat për mos përfundimin në afat të rehabilitimit të agregatit shoqërisë KESH SHA kanë shkaktuar një efekt financiar negativ si fitim i munguar në vlerën totale **397,795,018 lekë** (përkatesisht 313,681,491 lekë për vitin 2015 dhe 84,113,527 lekë për vitin 2017) . Efekti është krijuar nga vënia në punë e agregatit përtej çdo afati të përcaktuar dhe mbi të cilat janë hartuar planet e biznesit për rikthimin e investimit dhe shlyerjen e kredive (*Më hollësisht trajtuar në pikën 7 në faqet nr. 55-58 të Raportit Përfundimtar të auditimit*).

2.1 Rekomandim: Nga KESH SHA të merren masa për analizimin e shkaqeve dhe nxjerrjen e përgjegjësi lidhur me të ardhurat e munguara në shumën prej **397,795,018 lekë**. Gjithashtu, në të ardhmen, projektet me financime të huaja, të realizohen brenda afateve të përcaktuar në marrëveshjet financiare, me qëllim që mos të ketë zvarritje të cilat çojnë në ndryshime të kushteve të kontratave dhe në kosto shtesë të financimit, pasi për projektin “Siguria e Digave” vetëm nga mosrealizimi brenda afatit të përcaktuar kanë ndryshuar kushtet e kontratës, duke sjell një efekt negativ në shumën **397,795,018 lekë**.

Në vijimësi

D. MASA ADMINISTRATIVE

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenit 7 dhe 12 i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar, mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, ndryshuar me nenin 12 të ligjit nr. 183/2014 datë 01.04.2013 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë**, Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare KESH SHA, t’i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor Pukë, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe **të vendosë masë administrative me gjobë për 1 mbikëqyrës dhe 1 kolaudator** punimesh, si më poshtë:

1. **Ing. R. Gj.**, përfaqësues ligjor i subjektit mbikëqyrës “R... C...”;

2. **Ing. T. S.** përfaqësues ligjor i subjektit kolaudues të punimeve “M... St...”;

për shkeljet e konstatuara në objektin “Konsolidimi i bjefit të poshtëm të Komanit dhe largimi i depozitimeve në kanal in e shkarkimit”, me sipërmarrës punimesh OE “P... B... G...”, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **27,299,778 lekë (196,054.39 €)** si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt apo prej mos prej mos aplikimit të penalteteve për vonesa në përfundimin në afat të punimeve të kontratës (*Më hollësisht trajtuar pikën 6.1 në faqet 23-38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Menjëherë

E. MASA DISIPLINORE

Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen sipas kodit të punës.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, kontratën individuale, dhe nenet 37 dhe 144, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, **i rekomandojmë Administratorit të KESH SHA** që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH për periudhën 01.01.2015 deri më 30.06.2018, të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore si më poshtë:

E/1 “Largim nga puna”

1. Për z. F. B. në cilësinë e Drejtorit të PMU – së, për shkeljet e mëposhtme:

- Mos marrjen e masave për evidentimin e likuidimit tepër në vlerën **27,299,778 lekë** ndaj sipërmarrësit të punimeve “P... B... G...”, për punime të pakryera në fakt dhe për mos

aplikimin e penaliteteve për vonesa në përfundimin në afat të punimeve në objektin “Konsolidimi i bjeftit të poshtëm të Komanit dhe largimi i depozitimeve në kanalën e shkarkimit”;

- Mos marrjen e masave për evidentimin e likuidimit të shërbimeve të pakryera në fakt në vlerën **2,090,664 lekë** në kontratën me objekt “Asistencë teknike në implementimin e projektit” të lidhur me datë 16.12.2009, (e amenduar) me nr. DSP 01-09 mes KESH SHA në rolin e klientit e përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm dhe “A... C...” Ltd;
- Mos marrjen e masave për evidentimin e mbivendosjes së një pjese të shërbimeve me kontratave të konsulencës të lidhur sipas kontratës së datës 16.12.2009 me nr. DSP 01-09, e amenduar, mes KESH SHA në rolin e klientit e përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm dhe “A... C...” Ltd, konkretisht, amendamentit nr. 4 të datës 26.02.2016 si dhe dy kontratave të lidhura, asaj me nr. 7302/7 prot., datë 24.10.2014 mes Administratorit z. A. H. dhe operatorit ekonomik “C... R...” me vlerë 1,440,000 lekë me TVSh si dhe asaj me nr. 8037/2 prot., datë 03.02.2015 Administratorit z. A... H... dhe operatorit ekonomik “C... R...” me vlerë **6,270,000 lekë** me TVSh;
- Mos marrjen e masave për përcaktimin e saktë të penaliteteve ndaj “A... H... G...” ku si rrjedhojë janë përlloritur dhe arkëtuar më pak vlera **24,254,028 lekë**, (10,788,620 lekë për vitin 2015 dhe 13,465,408 lekë për vitin 2017);
- Mos marrjen e masave për zbatimin në kohë të kontratës së sipërmarrjes të lidhur në korrik të 2012 midis KESH SHA dhe A... H... G... për “Rehabilitimin Elektromekanik dhe instalimin e kontrolleve të reja dhe monitorimin me sistemin (CMS) të HEC Koman”, konkretisht të rehabilitimit të agregatit, me pasojë kjo një efekt financiar negativ si fitim i munguar në vlerën totale **397,795,018 lekë** (përkatësisht 313,681,491 lekë për vitin 2015 dhe 84,113,527 lekë për vitin 2017);

Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, kontratat përkatëse për punime apo shërbime si dhe Rregulloren e Përgjithshme të KESH SHA, pikës 14.1,

E/2 “Vërejtje” deri në **“Largim nga puna”** për:

1. znj. D. P., me detyrë specialiste e PMU e cila asiston dhe ndjek kontratat për punimet monitoruese të digave, hidroteknike dhe civile.

Për shkeljet e mëposhtme:

- Mos marrjen e masave për evidentimin e likuidimit tepër në vlerën **27,299,778 lekë** ndaj sipërmarrësit të punimeve “P... B... G...”, nga të cilat vlera 23,953,128 lekë prej likuidimit të punimeve të pakryera në fakt si dhe vlera 357,616 lekë prej mos aplikimit të penaliteteve për vonesa në përfundimin në afat të punimeve në objektin “Konsolidimi i bjeftit të poshtëm të Komanit dhe largimi i depozitimeve në kanalën e shkarkimit”;

Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, kontratë për punime si dhe Rregulloren e Përgjithshme të KESH SHA, pikës 14.2.

2. znj. E. P., me detyrë specialiste finance pranë PMU – së e cila ndjek dhe asiston pagesat e kontratave.

Për shkeljet e mëposhtme:

- Mos marrjen e masave për evidentimin e likuidimit të shërbimeve të pakryera në fakt në vlerën **2,090,664 lekë** si dhe likuidimit të shërbimeve pa dokumenteve shoqëruese në

momentin e likuidimit në kontratën me objekt “Asistencë teknike në implementimin e projektit” të lidhur me datë 16.12.2009, (e amenduar) me nr. DSP 01-09 mes KESH SHA në rolin e klientit e përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm dhe “A... C...” Ltd;

Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kreu III, pika 35 germa b, pikës 36.

F. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR.

Për ish punonjësen **znj. E. S.** me detyrë ish-specialiste e financës pranë PMU – së nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personi i sipërpërmendur nuk është në marrëdhënie pune me këtë subjekt dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre. Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte “Vërejtje” deri në “Largim nga puna”.

Në rastin e fillimit të procedurave gjyqësore në funksion të zbatimit të këtyre rekomandimeve, nga ana e KESH SHA, të kërkohet prezenca e KLSH-së, si palë e tretë në proces gjyqësor, duke informuar njëkohësisht KLSH-në, në lidhje me ecurinë dhe zhvillimet përgjatë proceseve gjyqësore.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja.

GRUPI I AUDITIMIT

1. J. H.,
2. S. H.,
3. A. A.,
4. A.R.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R